



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 77/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.02.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës konkurruese “E hapur”, me objekt: “Për kontrollin ligjor të instrumentave matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës (GLN)”, me nr. REF-85913-09-17-2018, me fond limit 64.890.600 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.10.2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Ankimues: “Penzoil Trading SA”
Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Toëer, Kati 5, Zyra 5/2, Tiranë

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë koncensionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat konkurruese, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.09.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura konkurruese “E hapur”, me objekt: “*Për kontrollin ligjor të instrumentave matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës (GLN)*”, me nr. REF-85913-09-17-2018, me fond limit 64.890.600 lekë.

II.2. Në datën 28.09.2018, operatori ekonomik ankimues “Penzoil Trading SA” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

Kjo ankesë paraqitet bazuar ne nenin 43 per rishikimin administrativ të ligjit 125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”, sipas te cilit, në rastin e ankesave per dokumentet e procedures konkurruese, operatoret ekonomikë kane të drejte te ankimojne brenda 10 diteve nga dita -e neserme e publikimit te njoftimit të kontratës në faqen zyrtare te Agjencisë së Prokurimit Public.

Sipas verifikimit ne faqen e APP-se, njoftimi i kontrates ne fjalë eshtë publikuar në datë 18 Shtator 2018 në faqen e APP-së (shih foton bashkëngjitur), dhe njëdhimisht me nisjen e afatit nga data 19 Shtator, datë kjo që përkon me të nesërmen e publikimit të njoftimit, ky ankim paraqitet në afatin brenda të cilit mund të paraqiten ankimet sipas nenit 43 të ligjit të sipërpërmendur.

Ankuesi paraqet këtë ankesë në lidhje me dokumentet e procedures për Njoftimin e Kontratës për procedurën e hapur, Koncesion i Shërbimeve Publike me objekt “Për dhënien me koncëion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, bazuar në aktet e mëposhtme ligjore:

Ligji nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;

VKM nr.575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat” i ndryshuar;

VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

VKM nr. 365 datës 20.06.2018 “Për dhënien me koncension te shërbimit të kontrollit ligjor të instmmenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpëmdarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese”.

Ligj nr.9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar.

1. Kriteret e kualifikimit të parashikuara në DSK

Kriteret e parashikuara në shtojcën 8 të DSK, (ku parashikohen kriteret e përgjithshme dhe të vecanta Iaë pranimit/kualifikimit të operatorëve), janë në kundërshtim me parimet themelore të parashikuara në nenin 9 të Ligjit “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat” i cili parashikon se një procedurë për dhënien e konkensioneve apo partneritetit publik privat, zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore. Gjithashtu VKM nr.575, datë 10.07.2013 parashikon në nenin 23 se “Kriteret për dhenien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese. . . ”

Konkretisht:

(a) Kriteret ekonomike financiare

Ndër kriteret e parashikuara, konkretisht referuar kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 2.2, shtoja 8 e DK), kërkohen kopje të pasqyrave financiare të dy viteve të fundit ushtrimore të paraqitura ne autoritetet përkatëse si degë të Drejtorise së Përgjithshme të Tatimeve dhe të konfirmuara nga ky autoritet me qëllim që të vërtetojnë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm të subjektit.

Në radhë të parë, është e paqartë se çfarë do të kuptohet me “aktivitet pozitiv të qëndrueshëm” duke qënë se për të bërë këtë vlerësim nuk parashikohet ndonjë vlerë referencë e xhiros vjetore të ofertuesit apo nese mjafton fakti që ky i fundit të mos rezultojë me humbje sipas të dhënave ne pasqyrat e depozituara fmanciare. Një perifrachim i tillë lejon një marzh shumë të madh diskrecioni në duart e Komisionit vlerësues dhe gjithashtu, krijon pasiguri ligjore për ofertuesit e mundshëm të cilët nuk mund të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë objektive nëse situata e tyre financiare është e tillë që të mund të kënaqë kerkesat e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Së dyti, AK kërkon që kopjet e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit (2016 dhe 2017) të jenë të konfirmuara autoritetet tatimore. Nuk është e qartë kjo kërkesë. Si rregull, në përputhje me VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” që flet për “kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura ne autoritetet perkatese”, duhet që AK të kërkoje nga subjektet ofertuese pasqyrat financiare të certifikuara sipas kerkesave të ligjit përkatës, paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore por jo të konfirmuara nga këto autoritete. Pra kërkesa e AK për pasqyra të konfirmuara bie në kundërshtim me dispozitat ligjore që kërkojnë vetëm pasqyrat të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse me qëllim garantimin e rregullsisë së tyre, dhe jo sepse duhet të vërtetohen apo miratohen nga ato autoritete.

Së treti, kërkesa e DSK që subjektet ofertuese të paraqesin pasqyrat financiare dhe kopjet e deklarimit të xhiros vjetore për dy vitet e fundit, nuk ashtë në harmoni me kërkesën e parashikuar

në seksionin 2.3 të Shtojcës 8 ku parashikohen kërkesa në lidhje me kapacitetet teknike, dhe shprehimisht me pikën 1 ku kërkohet eksperiencë në fushën e inspektimit dhe matjes brenda tre viteve të fundit. Në mënyrë që të ketë një përputhje mes këtyre periudhave, propozohet që pasqyrat financiare dhe deklaratimet e xhiros të tregojnë rezultatet për tre vitet e fundit, nga 2015 deri në 2017.

Në përputhje me sa më sipër, kërkohet që parashikimi në pikën 2.2 në shtojcën 8 të bëhet: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit ushtrimore (2015- 2017) të dorëzuara në autoritetet përkatëse tatimore dhe certifikuar sipas ligjit përkatës të vendit ku operon ofertuesi”. Gjithashtu, po në lidhje me këtë kërkesë, AK duhet të përcaktojë rregulla transparente mbi kërkesën e vërtetimit të aktivitetit pozitiv të qëndrueshëm” të ofertuesit.

(b) Kriteret teknike

Në kuadër të kualifikimit të operatorëve përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Autoriteti ka përcaktuar disa kërkesa në Shtojcën 8 të cilat vijnë në kundërshtim me ligjin.

Konkretisht:

Së pari, në Shtojcën 8, Pika 2.3 (1) në lidhje me kërkesën e operatorit për të dokumentuar eksperiencën me kontrata shërbimi, jemi të mendimit se kjo kërkesë është e tepërt sidomos në lidhje me operatorët e huaj të cilët brenda afatit të shkurtër të përcaktuar në dokumentet e tenderit duhet jo vetëm të lokalizojnë kontratat përkatëse por dhe t'i përkthejnë ato në gjuhën shqipe me vërtetim noterial të apostiluar. Sipas nenit 28 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktues si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/ose faturave tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”. Neni vijon më tej dhe parashikon se në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar në sektorin privat pranohen vetëm fatura tatimore shitje duke përjashtuar shprehimisht kontratat.

Sa më sipër, kërkesa 1 në pikën 2.3 të Shtojcës 8 duhet të saktësojë llojin e dokumenteve të pranuar për të provuar eksperiencën e mëparshme duke pranuar në lidhje me këtë pikë edhe vetëm vërtetime apo fatura përkatëse shitjeje.

Së dyti, po në lidhje me pikën 1 të paragrafit 2.3 të Shtojcës 8, kundërshtojmë faktin, që ndryshe nga shumica e precedentëve në procedura koncesioni, kriteri teknik kualifikues në pikën 1 të paragrafit 2.3 nuk parashikon asnjë element sasior (p.sh. fatura me një vlerë x, kontrata me një vlerë x, etj) si tregues i rëndësisë së projekteve të realizuara nga ofertuesit që do të shërbejë për vlerësimin e eksperiencës së operatorëve dhe kualifikimin e tyre nga komisioni i vlerësimit. Mungesa e vlerave të referencës krijon mundësinë e komisionit të vlerësimit që të vlerësojë në mënyrë subjektive ofertuesit e kualifikuar duke cënuar kështu hapazi parimin e transparencës dhe

paanshmrisë së procesit në kundërshtim me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.

Në këtë linjë dhe në mbështetje të argumentit të mësipërm, shtojmë se paradoksalisht paragrafi i fundit i pikës 1 të seksionit 2.3 të Shtojcës 8 parashikon se “..pikat e mësipërme në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Për sa kohë AK nuk ka përcaktuar asnjë element vleror (sasior) në lidhje me shërbimet e shkuara të ofertuesve të cilët mund të dëshmojnë për eksperiencën e tyre të mëparshme në lidhje me shërbimet e kërkuara nga koncesioni, atëherë nuk është e qartë se si mund përlllogaritet ndarja e faturave/shërbimeve/kontratave përkatëse në rast kur një ofertues paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë.

Së treti pika 2 e seksionit 2.3 të shtojcës nr.8 të DSK kërkon që operatorët ekonomikë të paraqesin certifikatë akreditimi të llojit ISO/IEC17020:2012 në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Kërkesa e mësipërme e cila specifikon fushën e veprimtarisë vetëm në inspektimin e shpërndarësve të karburantit, ngushton rrethin e operatorëve pjesëmarrës të cilët mund të jenë aktivë dhe në fushën e inspektimit të matësve në mjekësi apo në pikat e shumicës të terminalëve të shpërndarjes të karburantëve, duke qënë se në parim konsistojnë në të njëjtën lloj veprimtarie si ajo e kontrollit të matësve në shpërndarësit e karburantëve ndaj, duhet të lihet i hapur sektori në të cilin ushtrohet inspektimi dhe në të cilin subjekti është i akredituar për të ofruar shërbim.

Gjithashtu, ky kriter i vendosur është haptazi diskriminues për ofertuesit e huaj për sa kohë kërkohet që certifikata në fjalë të jetë lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, një kërkesë kjo e mundur për t’u realizuar vetëm nga subjekte të regjistruara në Shqipëri. Në përputhje me precedentë të mëparshëm të pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, çdo kërkesë e cila ka të bëjë me certifikata apo leje të lëshuara nga autoritete/agjenci shqiptare, është gjykuar si diskriminuese për subjekte të huaja dhe në kundërshtim flagrant me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet dhe PPP si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, e cila duhet të adresohet menjëherë nga Autoriteti Kontraktues.

Propozojmë që sa më sipër, të hiqet parashikimi “të” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit” dhe të bëhet “të lëshuar nga DPA ose për subjektet e huaja, nga autoritetet përkatëse të shtetit të ofertuesit.

2. Forma e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi

Në lidhje me formën e dokumenteve të ofertuesve të huaj, DSK dhe konkretisht Shtojca 8 kanë parashtruar kërkesa kontradiktore përsa i përket gjuhës së dokumentave. Konkretisht, në një paragraf të Shtojcës 8 kërkohet që cdo dokument në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim noterial ndërsa paragrafi i mndit i Shtojcës 8 parashikon dhe pranimin e dokumenteve në gjuhën angleze.

Kërkojmë që të sqarohet përfundimisht gjuha e dokumenteve të huaj dhe Autoriteti Kontraktues të sqarojë në DSK edhe pranimin e dokumenteve në gjuhën angleze ne mbështetje të Ligjit 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, i cili parashikon në nenin 1 të tij se ka për qëllim “...të krijojë një kuader të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet si koncensione partneritete publike private”.

3. Mungesa e Studimit të Fizibilitetit; Shtojca 10 Kriteret e Vlerësimit

Në seksionin 5.3 të DSK (Informacione shtesë) parashikohet se dokumentacioni i cili do të ngarkohet në faqen e APP-se si (studimi i fizibilitetit, detyrat e projektimit, etj) i cili do t'i bashkëlidhet dokumentave të tenderit është referues (orientues) për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e koncesionit.

Në rastin konkret, në faqen e APP nuk është ngarkuar studimi i fizibiliteti duke cënuar haptazi parimin bazë të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve pasi na privon nga informacioni bazë në funksion të vlerësimit tonë të plotë për të marrë pjesë ose jo në procedurë si dhe realizimin e një oferte të plotë dhe të kënaqshme sipas pritshmërive të AK dhe kërkesave në DSK. Ky informacion në rastin konkret, duket se është i privilegjuar vetëm për shoqërinë NOA Control e cila e ka hartuar vetë këtë studim. Një mënyrë e tillë operimi favorizon dukshëm ofertuesin e mundshëm të cilit i është akorduar dhe bonusi, NOA Control.

Jo vetëm kaq, por mungesa e studimit të fizibilitetit dhe të dhënat e tij në lidhje me situatën aktuale në treg, numrin e pompave, standanet dhe perceptimin e publikut etj, nuk na japin mundësinë që të kemi bazën e nevojshme (supozimet) mbi të cilat të mundet që të ndërtojmë modelin tonë financiar dhe planin e biznesit sipas kërkesës të parashikuar në pikën 2.2 (e) Shtojca 8 n'e' të cilin kërkohet që ofertumi të hartojë një model financiar i cili duhet të përmbajë 'e' pasqyrat financiare të fluksit të parasë (Cash Floë), të ardhurat, shpenzimet kapitale, shpenzimet operative, burimet e financimit të projektit, riinvestimin si dhe indikatorët financiarë si IRR, NPV etj; për gjithë kohëzgjatjen e kontratës; të përgatisim në kushte të barabarta me ofertuesin të cilit i është dhënë bonusi ofertën teknike dhe financiare për vlerësim sipas kriterëve të parashikuara në Shtojcën 10 të DSK, konkretisht KT2, KFl (vlera totale e investimit) dhe KF2 (tarifa e koncesionit).

Sa më sipër, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të vendos në dispozicion të procedurës konkurruese shtimin e fizibilitetit për këtë koncesion.

4. Ky koncesion nuk duhet trajtuar si propozim i pakërkuar VKM nr. 575/2013 "Per miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat", i ndryshuar, parashikon në nenin 10, pika 1 se cdo operator ekonomik ose grup operatorësh mund të paraqesin një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP, kjo me kusht që propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve të parashikuar në nenin 4 të Ligjit për Koncensionet dhe Partneritetin Publik Privat. Shërbimi që do të ofrohet nga koncensionari në këtë rast nuk i përket asnjë prej sektorëve të parashikuar në nenin 4 të ligjit të cituar më sipër, i cili parashikon sektorët e mëposhtëm:

a) transport (sistemin e hekurudhave, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimin, transportin publik);

b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;

c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;

ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;

d) telekomunikacion;

dh) shkencë dhe arsim;

e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;

ë) kulturë dhe sport;

f) shëndetësi;

g) shërbime sociale;

gi) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;

h) rehabilitim i tokës dhe pyjeve;

i) parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;

j) strehim;

k) godina të administratës publike, teknologji e infomacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;

l) shpërndarje e gazit natyror;

ll) rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban;

m) ndricimi publik ne territorin e njësive administrative vendore;

n) bujqësi.

Në gjykimin tonë, kontrolli ligjor i instrumenteve matës te shpërndarëve të karburantit nuk përfshihet në asnjë prej sektorëve të mesipërm për të cilët lejohet paraqitja dhe për rrjedhojë marrja në konsideratë nga AK i një propozimi të pakërkuar. Në këto kushte, jemi të mendimit se KPP duhet të udhëzojë AK që të trajtojë këtë koncesion me anë të një procedura standarte të hapur pa akorduar bonus për subjektin i cili ka hartuar studimin e fizibilitetit.

5. Paqartësi në lidhje me Shtojcën 12 (Specifikimet Teknike) dhe Shtojcën 16 (Kushtet e Vecanta të Kontratës)

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, konstatojmë se si Shtojca 12 ashtu edhe Shtojca 16 kanë mangësi të theksuara në lidhje me llojin dhe numrin e shërbimeve që do të mund të ofrohen nga Koncaionari si dhe vlerën/tarifën dysheme apo tavan për këto shërbime gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, element ky i cili përsëri vjen në kundërshtim flagrant me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet që parashikon trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomike në procedurat konkurruese.

Pa patur qartësi në lidhje me pikat e mësipërme, një ofertues e ka të pamundur të ndërtojë supozimet mbi të cilat do të ndërtojë planin e investimit dhe ri-investimit si dhe modelin e biznesit, të vlerësojë risqet ligjore dhe politike në lidhje me koncaionin si edhe përputhshmërinë e ofertës së tij me kuadrin ligjor në fuqi.

Për shembull, në Shtojcën 12, përmendet se operatori mund të vendosë gjopa ndaj subjekteve, të bëjë riparimet e matësve, kontroll vizual të matësve, kontrolle për herë të parë, kontrolle rastësore etj, të gjitha këto të cilat supozojnë shërbime të ndryshme të cilat mund të ofrohen nga koncaionari por pa përcaktuar në mënyre të saktë dhe të qarte në listën e shërbimeve të cilat do të ofrohen në bazë të këtij koncesionari nga Koncesionari dhe jo nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo ndonjë drejtori tjetër shtetërore.

Gjithashtu, në DSK parashikohet se tarifa ekzistuese është 7,200 Leke' (përfshirë TVSH) për cdo distributor sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Ekonominë dhe Financat nr.2, datë 08/02/2013 "Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme si edhe se frekuenca e verifikimeve " dhe se verifikimi periodik (pasardhës) për te ruajtur saktësinë e matjes së distributoreve të karburanteve dhe të gazit të lëngshëm bëhet do 6 muaj, sipas urdhrit të ministrit Nr.195, date 09/03/2009 "Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluara".

Por në DSK, nuk sqarohet nese pritshmëria e AK është që si tarifa ashtu dhe frekuenca e verifikimeve periodike do të mbeten të njëjta apo do të mund të ndryshohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit, dhe nëse mund të ndryshohet apo negociohen midis palëve, cilat janë marzhet mbi të cilat mund të kryhet kjo negociatë. Duke qënë se këto janë kushte kryesore komerciale të kontratës së koncesionit (pasi të ardhurat e koncesionit varen pikërisht nga këto dy kushte), gjykojmë se në DSK duhet të ishin përcaktuar qartë dhe në mënyrë të saktë:

- Lista rendore e shërbimeve të ofruara nga Koncesionari
- Cmimet aktuale për cdo shërbim dhe qartësi nëse këto cmime mund të ndryshohen ose jo gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
- Frekuenca e shërbimeve.

Një parashikim i tillë është në interes jo vetëm të ofertuesve potencialë të cilët duhet të konkurromë në procedura mbi premisa të barabarta por edhe, distributorëve dhe konsumatorëve fundorë për të shmangur abuzimet gjatë kohëzgjatjes së koncesionit nga koncesionari.

Sa më sipër, kërkojmë që KPP të udhëzojë Autoritetin Kontraktues të sqarojë në DSK:

- *Të gjitha shërbimet që mund të ofrohen nga Koncesionari;*
- *Marzhet brenda të cilëve mund të negociohen tarifat e shërbimeve;*
- *Frekuenca e shërbimeve.*

Në shumë raste, cmimi i shërbimit për përdoruesit fundorë është dhe kriter vlerësimi në përputhje me Nenin 23 të Ligjit për Koncesionet dhe mund të merret parasysh në Kriteret Financiare të Vlerësimit të ofertuesve.

Në përputhje me Nenin 43 të Ligjit për Koncesionet, çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes nënjë procedurë konkurruese dhe kur është demtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktues të koncesionit/partneritetit publik privat, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht për dijeni edhe autoritetit kontraktues. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktues pezullon vazhdimin e procedurës konkurruese deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga KPP-ja. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi përprocedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

Sa më sipër, kjo ankese për rishikim administrativ paraqitet drejtpërdrejt pranë KPP, për dijeni autoritetit kontraktues sipas nenit 43 të ligjit për koncesionet.

Në mbështetje të argumentave të renditura më sipër kërkojmë nga Komisioni sa më poshtë vijon:

- 1. Publikimin e studimit të fizibilitetit me të dhënat përkatëse në faqen e APP-së;*
- 2. Ndryshimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit sipas sugjerimeve tona (kriteret teknike dhe financiare) në lidhje me kriteret kualifikuese teknike dhe financiare;*
- 3. Saktësimin e termave të referencës dhe kushteve të vecanta komerciale të kontratës së koncesionit (llojin e shërbimeve, marzhet e tarifës së shërbimit dhe periodicitetit të tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit);*
- 4. Lejimin e paraqitjes së dokumenteve të huaja në gjuhën angleze;*

5. Anullimin e bonusit prej 10% të totalit të pikëve në favor të subjektit që ka paraqitur propozimin e pakërkuar.

II.3. Në datën 09.10.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 18871/2 prot., datë 9.10.2018, me objekt: *“Në lidhje me procedurën e hapur “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.*

II.4. Në datën 11.12.2018 me shkresën nr. 1539/4 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktues për informacionin dhe dokumentacionin e detajuar sipas të gjitha pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Në datën 20.12.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 2219/1 prot., datë 18.12.2018, me objekt: *“Në lidhje me kërkesën për informacion mbi procedurën e hapur “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktues lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar argumenton si më poshtë: [...]*

Ne përgjigje të Vendimit nr. 1539/1 prot., datë 01.10.2018, protokolluar me tonën me nr. 17871 , datë 04.10.2018, me anë të së cilës Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar pezullimin e procedurës së hapur “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, si dhe informacion në lidhje me këtë procedurë, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Së pari, me hyrjen në fuqi të Vendimit nr. 365, datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”, u nxorr Urdhri nr. 195, datë 12.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për krijimin e Komisionit të Dhënies së Koncesionit për kryerjen e aktiviteteve që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit.

Pas dhënies së miratimit të Studimit të Fizibilitetit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sipas parashikimeve të legjislacionit për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, Komisioni i Koncesionit vijoi punën me përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/ Partneritet Publik Privat të ndryshuar.

Pas miratimit të dokumenteve të tenderit, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik u publikuan këto dokumente me informacionet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi. Procedura konkurruese u përzgjedh të jete “procedura e hapur” dhe afati kohor për dorëzimin e ofertave

apo kërkesave për pjesëmarrje nga operatorët ekonomikë, u përcaktua 30 ditë, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, bëjmë me dije se procedura është në fazën e pritjes së dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomik'e' dhe aktualisht është pezulluar deri në marrjen e vendimit nga ana e Institucionit tuaj. Në Vijim, është nxjerrë Urdhri nr. 256, datë 05.10.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë.

Së dyti, për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik të interesuar “Penzoil Trading S.A”, të paraqitura në Seksionin III “Përshkrimi i ankesës”, e specifikisht pika 2 “Deklaratë e hollësishme e fakteve dhe argumenteve”, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

Në lidhje me pikën I “Kriteret e kualifikimit të parashikuara në DSK”, gërma “a” “Kriteret Ekonomike Financiare”, sqarojme se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nuk janë në kundërshtim me ligjin, pasi:

- *Për aq kohë sa nuk parashikohet një vlerë referencë e xhiros vjetore, do të thotë që me konceptin “aktivitet pozitiv i qëndrueshëm” të përmbushet kërkesa për pasqyra financiare pozitive, pra në Vitet e kërkuara, shoqëria të tregojë stabilitet financiar. Kjo është mbështetur në gërmën “c” të nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili për kualifikimin e ofertuesve në lidhje me kriteret ekonomike e financiare, parashikon: “c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”. Pra, sipas këtij parashikimi ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do të kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave financiare dhe nuk ka lidhje me diskrecionin në duart e Komisionit, pasi kjo vlerë është njësoj e pranueshme dhe e njohur nga të gjithë, si nga ofertuesit e mundshëm, si nga organet tatimore, ashtu edhe nga Komisioni i Koncesionit. Rikujtojmë gjithashtu se, pasqyrat financiare përbëjnë kriter kualifikimi sipas dispozitave ligjore në fuqi të cilat rregullojnë procedurat e tenderimit, e konkretisht për procedurën në fjalë, nuk përbëjnë as element selektiv ndërmjet operatorëve të mundshëm dhe as element vlerësimi për pikëzim nga ana e Komisionit të Koncesionit.*
- *Me konceptin “.... të konfirmuara nga ky autoritet”, do të kuptojmë që operatori ekonomik ka paraqitur pasqyrat financiare pranë institucionit përkatës sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe nga institucioni përkatës tatimor është konfirmuar dorëzimi. Pra, nuk kërkohet që të jenë të kontrolluara nga organet tatimore, por të mbartin vulën e këtij organi*

që konfirmon se janë kopja e njehsuar me origjinalin e dorëzuar pranë tyre. Kjo është një praktikë e përdorur gjerësisht ne procedurat e prokurimit dhe ato te procedurave koncesionare.

- *Në lidhje me pretendimin se kërkesa për pasqyrat financiare dhe kopjet e deklaratave te xhiros vjetore nuk janë ne harmoni me seksionin 2.3 të shtojcës 8, sqarojmë se këto dy kriteret nuk kanë asnjë lidhje me njera tjetrën pasi kërkohej për të vlerësuar kualifikimin e operatorëve ekonomikë në dy këndvështrime të ndryshme. Pasqyrat financiare kërkohej për të vërtetuar kapacitetet ekonomike për dy vitet e fundit ndërsa eksperiencën kërkohej për të vërtetuar kapacitetin teknik të operatorit në tre vitet e fundit. Gjithësesi, vlen të theksojmë se pasqyrat financiare të vitit korrent kanë të pasqyruar edhe të dhenat e vitit paraardhës që nënkupton se në pasqyrat e dy viteve të fundit gjendet informacion për tre vitet e fundit. Pra, për sa më sipër, shprehemi se kriteri për deklaratën e xhiros vjetore dhe pasqyrave financiare për dy vitet e fundit nuk ka arsye që të lidhet me kriterin teknik për eksperiencë në tre vitet e fundit.*
- *Për propozimin e operatorit në lidhje me paraqitjen e dokumenteve pranë autoritetve përkatëse tatimore dhe çertifikuar sipas legjisllacionit të vendit ku operon ofertuesi theksojmë se kjo kërkesë është parashikuar në Shtojcën 8, Seksioni 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3 paragrafi i fundit si më poshtë: “Për Operatorët e Huaj, dokumentacioni duhet të paraqitet në formën e kërkuar në përputhje me legjisllacionin e Republikës së Shqipërisë në rastin e moslëshimit të dokumentave të mësipërm në vendin e origjinës te përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit si dhe në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kriteret e mësipërme të rregullohen sipas legjisllacionit në vendin e origjinës pra operatori ekonomik i huaj mund të paraqese dokumenta ekuivalentë me to ose deklaratë me shkrim. Në rastin e paraqitjes së Ofertës apo dokumentacionit të parashikuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në monedhë të ndryshme nga ajo e aplikuar në Republikën e Shqipërisë, operatorët Ekonomikë do ti referohen kursit të këmbimit valutor të deklaruar nga Banka e Shqipërisë ditën e publikimit së procedurës në sistemin elektronik te APP-së “*

Në lidhje me pikën 1 “Kriteret e kualifikimit te parashikuara në DSK”, gërma “b” “Kriteret Teknike”, sqarojmë se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nuk janë ne kundërshtim me ligin, pasi:

- *Shqetësimi mbi kohën e lokalizimit dhe përkthimit të kontratave dhe faturave është i pabazuar në ligj për shkak se operatorët kanë në dispozicion 30 ditë kalendarike për këtë. Ne dokumentat e tenderit nuk është kërkuar numër apo vlerë për kontratat e mëparshme por është thjesht është përcaktuar si kërkesë kualifikuese për të vërtetuar eksperiencën.*
- *Se dyti, në lidhje me kërkesën për përcaktimim e një vlere për eksperiencën e mëparshme për kualifikim, shprehemi se nuk qëndron pretendimi se mungesa e vleres i jep mundësinë komisionit për të vlerësuar në mënyrë subjektive, pasi në kete rast nuk bëhet vlerësim por kualifikim. Gjithashm ne këtë rast kemi menduar se e rëndësishme është që operatori të kete kryer minimalisht nje shërbim të ngjashëm, duke mos diskriminuar asnjë operator që sot operon ne këtë fushe, qofte me eksperiencë me vlerë më të vogël se të tjerët. Kjo është*

edhe ne përputhje me parashikimet e Direktivës 2014/23/EU pika (63) “Për Dhënien e Kontratave të Koncesionit” e cila kërkon parashikimin e kriterëve të veganta për të favorizuar SME-te të marrin pjesë në procedura koncesioni.

- *Argumenti në lidhje me fjaline e fundit të pikës 1, e cila konsiderohet nga operatori si paradoksale, shërben për të ndaluar operatorët të cilët kryejnë bashkime të perkohshme me qëllim përmbushjen e kriterëve kualifikuese, por nuk përcaktojnë në marrëveshjen e bashkimit të perkohshëm rolin e secilës shoqëri. Pra, nëse një operator i bashkimit të perkohshëm ka deklaruar në marrëveshje se merr përsipër të kontribuojë vetëm në aspektin teknik të projektit, atëherë duhet të vërtetojë se ka eksperiencë në këtë fushë. Gjithashtu, nëse me shumë se një shoqëri shprehet në marrëveshje se do kontribuojë në aspektin teknik, atëherë të dy shoqëritë sëbashku duhet të paraqesin eksperiencat e tyre.*
- *Për sa i përket kriterit kualifikues në lidhje me kapacitetin teknik për akreditimin nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, shprehemi se ky kriter nuk është përjashtues për asnjë kategori operatorësh për aq kohë sa Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është autoriteti publik që vepron si shërbimi kombëtar i akreditimit në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se shërbimi që do të jepet me koncesion, shtrihet në territorin e RSH-së, është e logjikshme që të ketë njohje ligjore dhe besueshmëri nga një organ vendas në lidhje me të. Për më tepër, DPA ka parashikuar mundësinë e njohjes ose pajisjes me akreditimin përkatës, të organizmave që nuk janë pajisur në vendin tone me certifikimet përkatëse, sipas kërkesave ligjore për standardin ISO/IEC17020:2012 “Kërkesa të përgjithshme për operimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim”, sipas kërkesës se tyre ne përputhje me Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.*

Në lidhje me pikën 2 “Forma e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi”, sqarojmë se gjuha e dokumentacionit që do të paraqitet nga ofertuesit është gjuha shqipe. Kjo është në përputhje me rregullat e përgjithshme të vendosura nga Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në nenin 29 të Ligiit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili parashikon se në përmbajtjen e njoftimit të procedurës së hapur, duhet të përcaktohet gjuha e hartimit të ofertave. Për aq kohë sa në njoftimin e kontratës, është përcaktuar gjuha shqipe, nënkupton që dhe ofertat do të dorëzohet në këtë gjuhë.

Gjithashtu, sqarojmë se nga përcaktimi i bërë në Dokumentet e Tenderit, ku thuhet se “Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe ose angleze, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën “Apostille do të kuptohet se noterizimi apo vulosja “Apostille” përbën vlerën juridike që merr dokumenti, e vecanërisht për dokumentet nga vendet e huaja, nënkupton garanci ligjore për Autoritetin Kontraktues. Sa më sipër, nuk rrëzon kërkesën për paraqitjen e ofertave në gjuhën shqipe, por është një kërkesë legjitime për origjinalitetin e dokumentacionit që do të përbëjë ofertën.

Në lidhje me pikën 3 “Mungesa e Studimit të Fizibilitetit: Shtojca 10 Kriteret e Vlerësimit”, sjellim në vëmendje se informacioni teknik i nevojshëm për të giykuar mbi pjesëmarrjen në procedurën e hapur Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse,

nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, mund të merret nga Shtojca 12 “Termet e Referencës/ Specifikimet Teknike”, e cila është pjesë e Dokumenteve të Tenderit.

Në studimin e fizibilitetit, shoqëria ka parashikuar edhe të dhëna të cilat janë të lidhura ngushtë me teknologjinë e përdorur dhe parashikimet financiare, cka do të konsiderohet çënim i konkurrencës nga propozuesi i pakërkuar. Por pavarësisht sa më sipër, Autoriteti Kontraktues ka publikuar të gjitha të dhënat e nevojshme, sipas Shtojcës 12 të dokumenteve të koncesionit, duke përfshirë detaje edhe më të hollësishme se ato që kërkon ankimesi. Përsa i përket të dhënave të nevojshme për përgatitjen e kriterëve të vlerësimit, shprehem se publikimi i studimit të fizibilitetit jo vetëm që nuk i ndihmon operatorët, por i kufizon ata në përgatitjen e një oferte, e cila mund të mos jetë reale dhe ka tendencën të përafrohet me atë cka studiuar propozuesi i pakërkuar. Në rastin e koncesionit, në ndryshim nga prokurimi publik tradicional, vlera më e mirë për para arrihet nëpërmjet përgatitjes së studimit nga operatorët privatë, të cilët do të ofrojnë vlerën me të mirë duke zhvilluar projektin sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktues.

Ne lidhje me pikën 4 “Ky koncesion nuk duhet trajtuar si propozim i pakërkuar”, sqarojmë se Vendimi nr. 365, datë 20.06.2018 i K'eshillit të Ministrave, ka përcaktuar përfshirjen e shërbimit objekt propozimi në fushën e sektorëve që mund të jepen me koncesion/PPP, si dhe dhënien e bonusit për shoqërinë që ka paraqitur propozimin e pakërkuar. Nga interpretimi sistematik i legjislacionit që trajton koncesionet dhe partneritetin publik privat, arrijmë në konkluzionin se propozimi i pakërkuar referohet si një mënyrë ofrimi për të gjithë sektorët e mundshëm të koncesioneve e për sa kohë që Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë vendime për dhënien me koncesion në sektorë të tjerë, si dhe përdërisa ky përcaktim është vendosur brenda nenit 4 “Fusha e zbatimit të ligjit” të Ligiit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, të ndryshuar, do të thotë që qëllimi i ligjvënësimit është trajtimi i përgjithshëm i sektorëve të tjerë të mundshëm, në të njëjtën mënyrë si sektorët e përcaktuar.

Gjithashtu, sipas pretendimit të operatorit ekonomik që Autoriteti Kontraktues të trajtojë koncesionin me anë të një procedure standarte të hapur pa akorduar bonus për subjektin që ka hartuar studimin e fizibilitetit, rikujtojmë se ky nuk është diskrecion i Autoritetit Kontraktues, pasi dhënia me koncesion e këtij shërbimi, si dhe vlerësimi me bonus për propozuesin, janë përcaktuar në VKM-në e sipërmendur.

Në lidhje me pikën 5 “Paqartësi në lidhje me Shtojcën 12 (Specifikimet Teknike) dhe Shtojcën 16 (Kushtet e Vecanta të Kontratës)”, theksojmë se objekt koncesioni është shërbimi i kontrollit ligjor i instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, të përcaktuar në pikën 2.2 të “Njoftimit të Kontratës”. Ky shërbim do të shoqërohet nga ndërtimi i një platforme elektronike Online si dhe krijimi i një baze të dhënash mbi kontrollet periodike të bërë dhe rezultatet e tyre për qëllime evidence.

Ne Shtojcën 12, përcaktohet tillimisht lista e operacioneve (shih pikën 1.3.3 Kontrollat metrologjike ligjore) ku përfshihen:

- *Miratimi i Tipit*
- *Verifikimi Fillestar*
- *Verifikimi Periodik/Jashtë Radhe*
- *Kontrolli vizual-teknik, etj.*

Frekuenca e këtij shërbimi është përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 2, datë 08.02.2013 të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmanjes dhe Ministrisë të Financave. Në lidhje me çmimin e shërbimit, kjo është parashikuar në Shtojcën 12 “Termet e Referencës/ Specifikimet Teknike”, pika 1.1.2 6 cila shprehet se kjo tarife është 7.200 Lekë (përfshirë TVSH). Ndërsa për sa i përket rekomandimit të operatorit ekonomik mbi vendosjen e cmimit të shërbimit për përdoruesit fundor si kriter vlerësimi financiar, sqarohet se një kërkesë e tillë nuk mundet të jetë objekt vlerësimi apo rishikimi nga ana e Komisionit të Koncesionit, pasi është e mirërregulluar me Udhëzimin e siperpermendur, ende në fuqi[...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktues,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “[...] Ndër kriteret e parashikuara, konkretisht referuar kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 2.2, shtoja 8 e DK), kërkohen kopje të pasqyrave financiare të dy viteve të fundit ushtrimore të paraqitura ne autoritetet përkatëse si degë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të konfirmuara nga ky autoritet me qëllim që të vërtetojnë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm të subjektit.

Në radhë të parë, është e paqartë se çfarë do të kuptohet me “aktivitet pozitiv të qëndrueshëm” duke qënë se për të bërë këtë vlerësim nuk parashikohet ndonjë vlerë referencë e xhiros vjetore të ofertuesit apo nese mjafton fakti që ky i fundit të mos rezultojë me humbje sipas të dhënave ne pasqyrat e depozituara fmanciare. Një perifrazim i tillë lejon një marzh shumë të madh diskrecioni në duart e Komisionit vlerësues dhe gjithashtu, krijon pasiguri ligjore për ofertuesit e mundshëm të cilët nuk mund të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë objektive nëse situata e tyre financiare është e tillë që të mund të kënaqë kerkesat e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e tenderit. Së dyti, AK kërkon që kopjet e pasqyrave financiare të dy viteve të fundit (2016 dhe 2017) të jenë të konfirmuara autoritetet tatimore. Nuk është e qartë kjo kërkesë. Si rregull, në përputhje me VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” që flet për “kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura ne autoritetet perkatese”, duhet që AK të kërkojë nga subjektet ofertuese pasqyrat financiare të certifikuara sips kerkesave të ligjit përkatës, paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore por jo të konfirmuara nga këto autoritete. Pra kërkesa e AK për pasqyra të konfirmuara bie në kundërshtim me dispozitat ligjore që kërkojnë vetëm pasqyrat të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse me qëllim garantimin e rregullsisë së tyre, dhe jo sepse duhet të vërtetohen apo miratohen nga ato autoritete.

Së treti, kërkesa e DSK që subjektet ofertuese të paraqesin pasqyrat financiare dhe kopjet e deklaramit të xhiros vjetore për dy vitet e fundit, nuk ashtë në harmoni me kërkesën e parashikuar në seksionin 2.3 të Shtojcës 8 ku parashikohen kërkesa në lidhje me kapacitetet teknike, dhe shprehimisht me pikën 1 ku kërkohet eksperiencë ne fushen e inspektimit dhe matjes brenda tre viteve të fundit. Në mënyrë që të ketë një përputhje mes këtyre periudhave, propozohet që pasqyrat financiare dhe deklarimet e xhiros të tregojnë rezultatet për tre vitet e fundit, nga 2015 deri në 2017.

Në përputhje me sa më sipër, kërkojmë që parashikimi në piken 2.2 në shtojcën 8 te bëhet: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit ushtrimorë (2015- 2017) të dorëzuara në autoritetet përkatëse tatimore dhe certifikuar sipas ligjit përkatës të vendit ku operon ofertuesi”.

Gjithashtu, po në lidhje me këtë kërkesë, AK duhet të përcaktojë rregulla transparente mbi kërkesën e vërtetimit të aktivitetit pozitiv të qëndrueshëm” të ofertusit”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e koncensionit/ppp, Shtojca 8, pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, gërma “a”, është përcaktuar kriteri: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të Pasqyrave financiare të viteve ushtrimore (2016-2017) të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degë e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet”.

III.1.1.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për përcaktimin e termit “aktivitet pozitiv të qëndrueshëm”, sqarojmë se:

III.1.1.2. Autoriteti kontraktues në lidhje me këtë përcaktim sqaron se: “Për aq kohë sa nuk parashikohet një vlerë referencë e xhiros vjetore, do të thotë që me konceptin “aktivitet pozitiv i qëndrueshëm” të përmbushet kërkesa për pasqyra financiare pozitive, pra në Vitet e kërkuara, shoqëria të tregojë stabilitet fnciar. Kjo është mbështetur në gërmën “c” të nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili për kualifikimin e ofertuesve në lidhje me kriteret ekonomike e financiare, parashikon:

“c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

Pra, sipas këtij parashikimi ligjor dhe frymës së përgjithshme ekonomike mbi ecurinë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të një shoqërie tregtare, me konceptin në fjalë do te kuptohet vlerë pozitive e pasqyrave fnciare dhe nuk ka lidhje me diskrecionin në duart e Komisionit, pasi kjo vlerë është njësoj e pranueshme dhe e njohur nga të gjithë, si nga ofertuesit e mundshëm, si nga organet tatimore, ashtu edhe nga Komisioni i Koncesionit. Rikujtojmë gjithashtu se, pasqyrat financiare perbëjnë kriter kualifikimi sipas dispozitave ligjore në fuqi të cilat rregullojnë

procedurat e tenderimit, e konkretisht për procedurën në fjalë, nuk përbëjnë as element selektiv ndërmjet operatorëve të mundshëm dhe as element vlerësimi për pikëzim nga ana e Komisionit të Koncesionit”.

III.1.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

III.1.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “a”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse ...Omiss...

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës“.

III.1.1.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterit të veçanta të kualifikimit, për procedurën konkurruese objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.1.1.6. Referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP konstaton se synimi i autoritetit kontraktues me anë të kriterit të mësipërm është përmbushja me sukses e kontratës dhe për realizimin e synimit të mësipërm është parashikuar dorëzimi i bilanceve pozitive për dy vitet e fundit. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktues për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktues përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Në interpretimin teleologjik të nenit 46 pika 1 gërma “c” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, KPP gjykon se, qëllimi i normës së mësipërme juridike lidhet me vënien në dispozicion të autoriteteve kontraktuese të mekanizmave ligjorë mbi vendosjen e

kritereve të veçanta të kualifikimit (*aëard criteria*) me anë të cilave të vërtetohet se *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. Strictu sensu* ligjvënësi ka parashikuar edhe mjetet ligjore (dokumentacionin opsional) që mund të dorëzohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e synimit të normës juridike dhe njëherazi të qëllimit të autoritetit kontraktues si me anë të: deklaratave bankare ose, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në tre vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. Në ligjin nr.8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, referuar nenit 14, pika 1, parashikohet se: “*procedura e falimentit hapet me kërkesë të organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare*”. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të drejtë kërkesën e autoriteteve kontraktuese mbi dorëzimin e bilancave financiare për dy vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit tregëtar ushtrimor, si një e drejtë e cila rrjedh nga *lex specialis* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana tjetër, KPP, gjykon se, kërkesa e mësipërme lidhet *strictu sensu* me njohjen e aftësisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të marrë pjesë në qarkullim civil si subjekt tregëtar, si edhe duke shfaqur aftësi pagueuse ndaj të tretëve dhe ndaj shtetit.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite, është një parakusht që tregon rrezikun potencial të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ndër parimet kryesore të përgatitjes së pasqyrave financiare, referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SK) është ai *vijimësisë. Parimi i vijimësisë* do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

III.1.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktues mbi dorëzimin e bilanceve të qëndrueshme pozitive për dy vitet e fundit është në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është e përshtatshme për realizimin e synimit të autoritetit kontraktues.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.1.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për konfirmimin e bilancit sqarojmë se:

III.1.2.1. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “*Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik*”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “*Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit*”.

III.1.2.2. Në pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të*

përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.2.3. Në pikën 7 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon:*

a) kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose [...]”.

III.1.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncensionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.1.2.5. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, sqaron se: *[...] Me konceptin “.... të konfirmuara nga ky autoritet”, do të kuptojmë që operatori ekonomik ka paraqitur pasqyrat financiare pranë institucionit përkatës sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe nga institucioni përkatës tatimor është konfirmuar dorëzimi. Pra, nuk kërkohet që të jenë të kontrolluara nga organet tatimore, por të mbartin vulën e këtij organi që konfirmon se janë kopja e njehsuar me origjinalin e dorëzuar pranë tyre. Kjo është një praktikë e përdorur gjerësisht në procedurat e prokurimit dhe ato të procedurave koncesionare”.*

III.1.2.6. Sa më sipër, analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se në legjislacionin në fuqi është përcaktuar qartë që autoriteti kontraktues për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, çka rrjedhimisht është konfirmimi i këtij dokumenti nga organi pranë të cilit paraqitet, ndaj përcaktimi i këtij kriteri, nuk vjen në kundërshtim me bazën ligjore si më sipër cituar, si dhe nuk krijon pengesa për operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë konkurruese.

Rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit për këtë pikë nuk qëndron.

III.1.3. Përsa i përket pretendimit të ankimuesit se: *“kërkesa e DSK që subjektet ofertuese të paraqesin pasqyrat financiare dhe kopjet e deklaratimit të xhiros vjetore për dy vitet e fundit, nuk ashtë në harmoni me kërkesën e parashikuar në seksionin 2.3 të Shtojcës 8 ku parashikohen kërkesa në lidhje me kapacitetet teknike, dhe shprehimisht me pikën 1 ku kërkohet eksperiencë në fushen e inspektimit dhe matjes brenda tre viteve të fundit. Në mënyrë që të ketë një përputhje mes*

këtyre periudhave, propozohet që pasqyrat financiare dhe deklaratimet e xhiros të tregojnë rezultatet për tre vitet e fundit, nga 2015 deri në 2017”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.3.1. Në dokumentat e koncesionit /ppp, Shtojca 8, pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, janë përcaktuar kriteret: “*a. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të Pasqyrave Financiare të viteve ushtrimore (2016-2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse si Degët e DPT-së, të konfirmuara nga ky autoritet. b. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës”.*

III.1.3.2. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 28, përcaktohet se: “*Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon:*

- a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose*
- b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktues nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktues nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”*

III.1.3.3. Në nenin 46 të LPP përcaktohet se: “*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

III.1.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncesionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.1.3.5. Sa më sipër analizuar, gjykojmë se hartimi i këtij kriteri, referuar edhe bazës ligjore të sipërpërmendur, është përcaktuar brenda periudhës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktues ka bërë përcaktimin e këtij kriteri brenda parametrave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke mos i tejkaluar ato.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktues është në përputhje me objektin dhe natyrën e procedurës konkurruese, përsa kohë që nuk është përcaktuar asnjë element diskriminues dhe i paparashikuar në legjislacionin në fuqi,

Rrjedhimisht pretendimi i i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Së pari, në Shtojcën 8, Pika 2.3 (1) në lidhje me kërkesen e operatorit për të dokumentuar eksperiencën me kontrata shërbimi, jemi të mendimit se kjo kërkesë është e tepërt sidomos në lidhje me operatorët e huaj të cilët brenda afatit të shkurtër të përcaktuar në dokumentet e tenderit duhet jo vetëm të lokalizojnë kontratat përkatëse por dhe t'i përkthejnë ato në gjuhën shqipe me vërtetim noterial të apostiluar. Sipas nenit 28 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktues si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/ose faturave tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”. Neni vijon më tej dhe parashikon se në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar ne sektorin privat pranohen vetëm fatura tatimore shitje duke përjashtuar shprehimisht kontratat.*

Sa më sipër, kërkesa 1 në pikën 2.3 të Shtojcës 8 duhet të saktësojë llojin e dokumenteve të pranuar për të provuar eksperiencën e mëparshme duke pranuar në lidhje me këtë pikë edhe vetëm vërtetime apo fatura përkatëse shitjeje.

Së dyti, po në lidhje me pikën 1 të paragrafit 2.3 të Shtojcës 8, kundërshtojmë faktin, që ndryshe nga shumica e precedentëve në procedura koncesioni, kriteri teknik kualifikus në pikën 1 të paragrafit 2.3 nuk parashikon asnjë element sasior (p.sh. fatura me një vlerë x, kontrata me një vlerë x, etj) si tregues i rëndësisë së projekteve të realizuara nga ofertuesit që do të shërbejë për vlerësimin e eksperiencës së operatorëve dhe kualifikimin e tyre nga komisioni i vlerësimit. Mungesa e vlerave të referencës i krijon mundësinë komisionit të vlerësimit që të vlerësojë në mënyrë subjektive ofertuesit e kualifikuar duke cënuar kështu haptazi parimin e transparencës dhe paanshmërisë së procesit në kundërshtim me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.

Në këtë linjë dhe në mbështetje të argumentit të mësipërm, shtojmë se paradoksalisht paragrafi i fundit i pikës 1 të seksionit 2.3 të Shtojcës 8 parashikon se “..pikat e mësipërme në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Për sa kohë AK nuk ka përcaktuar asnjë element vleror (sasior) në lidhje me shërbimet e shkuara të ofertuesve të cilët mund të dëshmojnë për eksperiencën e tyre të mëparshme në lidhje me shërbimet e kërkuara nga koncesioni, atëherë nuk është e qartë se si mund përlllogaritet ndarja e faturave/shërbimeve/kontratave përkatëse në rast kur një ofertues paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e koncesionit/ppp, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, është përcaktuar kriteri: “2.3 Kapaciteti teknik: Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktues si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: 1. Eksperiencë në ekzekutimin e suksesshëm të punëve të ngjashme të një shërbimi në fushën e inspektimit dhe matjes brenda 3 viteve të fundit. Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme: a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Kontratë; dhe 2. Certifikatën e marrjes në dorëzim. b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Kontratë; dhe/ose 2. Fatura tatimore për cdo shërbim. Të dy pikat e mësipërme, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

III.2.2. Autoriteti kontraktues, në informacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se: “Në lidhje me pikën 1 “Kriteret e kualifikimit të parashikuara në DSK”, gërma “b” “Kriteret Teknike”, sqarojmë se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nuk janë në kundërshtim me ligjin, pasi:

- *Shqetësimi mbi kohën e lokalizimit dhe përthimit të kontratave dhe faturave është i pabazuar në ligj për shkak se operatorët kanë në dispozicion 30 ditë kalendarike për këtë. Në dokumentat e tenderit nuk është kërkuar numër apo vlerë për kontratat e mëparshme por është thjesht është përcaktuar si kërkesë kualifikuese për të vërtetuar eksperiencën.*
- *Se dyti, në lidhje me kërkesën për përcaktimim e një vlere për eksperiencën e mëparshme për kualifikim, shprehemi se nuk qëndron pretendimi se mungesa e vlerës i jep mundësinë komisionit për të vlerësuar në mënyrë subjektive, pasi në këto rast nuk bëhet vlerësim por kualifikim. Gjithashtu në këtë rast kemi menduar se e rëndësishme është që operatori të këto kryer minimalisht një shërbim të ngjashëm, duke mos diskriminuar asnjë operator që sot operon në këtë fushë, qoftë me eksperiencë me vlerë më të vogël se të tjerët. Kjo është edhe në përputhje me parashikimet e Direktivës 2014/23/EU pika (63) “Për Dhënie të Kontratave të Koncesionit” e cila kërkon parashikimin e kriterëve të vecanta për të favorizuar SME-te të marrin pjesë në procedura koncesioni.*
- *Argumenti në lidhje me fjaline e fundit të pikës 1, e cila konsiderohet nga operatori si paradoksale, shërben për të ndaluar operatorët të cilët kryejnë bashkime të perkohshme*

me qëllim përmbushjen e kriterëve kualifikues, por nuk përcaktojnë në marrëveshjen e bashkimit të përkohshëm rolin e secilës shoqëri. Pra, nëse një operator i bashkimit të përkohshëm ka deklaruar në marrëveshje se merr përsipër të kontribuojë vetëm në aspektin teknik të projektit, atëherë duhet të vërtetohet se ka eksperiencë në këtë fushë. Gjithashtu, nëse me shumë se një shoqëri shprehet në marrëveshje se do kontribuojë në aspektin teknik, atëherë të dy shoqëritë sëbashku duhet të paraqesin eksperiencat e tyre.

III.2.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktues si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

III.2.4. Në pikën 2 të nenit 22 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, përcaktohet shprehimisht: “Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik”.

Në pikën 5, neni 23 po këtu, përcaktohet se: “Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit”.

III.2.5. Në pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Në pikën 6 po këtu është përcaktuar: “[...] Autoriteti kontraktues, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve”.

Gjithashtu, në dokumentat standarte të koncensionit/ppp, të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik e të publikuara në faqen zyrtare të saj, në shtojcën 9, tek seksioni Kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar që autoriteti kontraktues duhet të plotësojë kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe atë teknik.

III.2.6. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për përvojën e mëparshme dhe në këtë kuadër, kontrata është një

dokument që dëshmon më së miri përvojën e mëparshme të realizuar nga një operator ekonomik, pasi është një dokument që sigurohet nga të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar dhe që përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të vërtetuar punët e mëparshme të realizuara si data e lidhjes së kontratës, vlera e realizuar, objekti i kryer, palët kontraktuese etj.

Autoriteti kontraktues në varësi edhe të kontratës, komplikimit të saj, natyrës, përmasave, mund të përcaktojë edhe kriteret të cilat janë të domosdoshme për të vërtetuar aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Vlerësojmë se, përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktues për paraqitjen e kontratës së mëparshme të ngjashme, nuk është diskriminues, përse kohë që ky dokument përmban të gjitha të dhënat e mjaftueshme për të verifikuar eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kontrata është një dëshmi që provon më së miri eksperiencat e mëparshme të realizuara nga operatori ekonomik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.7. Përse i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues në lidhje për përcaktimin e një vlerë për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ashtu siç edhe autoriteti kontraktor argumenton (citojmë): *“[...] duke mos diskriminuar asnjë operator që sot operon në këtë fushë, qoftë me eksperiencë me vlerë më të vogël se të tjerët. Kjo është edhe në përputhje me parashikimet e Direktivës 2014/23/EU pika (63) “Për Dhënien e Kontratave të Koncesionit” e cila kërkon parashikimin e kriterëve të vecanta për të favorizuar SME-te të marrin pjesë në procedura koncesioni. [...] nuk është kërkuar numër apo vlerë për kontratat e mëparshme por është thjeshtë është përcaktuar si kërkesë kualifikuese për të vërtetuar eksperiencën. Se dyti, në lidhje me kërkesën për përcaktimim e një vlere për eksperiencën e mëparshme për kualifikim, shprehemi se nuk qëndron pretendimi se mungesa e vleres i jep mundësinë komisionit për të vlerësuar në mënyrë subjektive, pasi në këto rast nuk bëhet vlerësim por kualifikim. Gjithashtu në këtë rast kemi menduar se e rëndësishme është që operatori të ketë kryer minimalisht një shërbim të ngjashëm, duke mos diskriminuar asnjë operator që sot operon në këtë fushë, qoftë me eksperiencë me vlerë më të vogël se të tjerët”, një përcaktim i tillë i kriterit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të ngjashme, është bërë me qëllim krijimin e lehtësirave për një pjesëmarrje sa më të gjerë me synim arritjen e qëllimit final, që është vlera më e mirë që mund të përfitohet nga paraja (publike), ose e thënë ndryshe, shërbimi/malli/puna më e mirë duke përmbushur kriteret kualifikuese, që mund të blihet me çmimin më të ulët që i siguron ato, e si rrjedhim realizimin me sukses të kontratës.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me vlerën e kontratave të ngjashme, nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Së treti pika 2 e seksionit 2.3 të shtojcës nr.8 të DSK kërkon që operatorët ekonomikë të paraqesin certifikatë akreditimi të llojit*

ISO/IEC 17020:2012 në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Kërkesa e mësipërme e cila specifikon fushën e veprimtarisë vetëm në inspektimin e shpërndarësve të karburantit, ngushton rrethën e operatorëve pjesëmarrës të cilët mund të jenë aktivë dhe në fushën e inspektimit të matësve në mjekësi apo në pikat e shumicës të terminalëve të shpërndarjes të karburantëve, duke qënë se në parim konsistojnë në të njejtën lloj veprimtarie si ajo e kontrollit të matësve në shpërndarësit e karburantëve ndaj, duhet të lihet i hapur sektori në të cilin ushtrohet inspektimi dhe në të cilin subjekti është i akredituar për të ofruar shërbim.

Gjithashtu, ky kriter i vendosur është haptazi diskriminues për ofertuesit e huaj përsa kohë kërkohet që certifikata në fjalë të jetë lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, një kërkesë kjo e mundur për t'u realizuar vetëm nga subjekte të regjistruara në Shqipëri. Në përputhje me precedentë të mërrparshëm të pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, cdo kërkesë e cila ka të bëjë me certifikata apo leje të lëshuara nga autoritete/agjenci shqiptare, është gjykuar si diskriminuese për subjekte të huaja dhe në kundërshtim flagrant me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet dhe PPP si dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila duhet të adresohet menjëherë nga Autoriteti Kontraktues.

Propozojmë që sa më sipër, të hiqet parashikimi “të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit” dhe të bëhet “të lëshuar nga DPA ose për subjektet e huaja, nga autoritetet përkatëse të shtetit të ofertuesi”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e koncesionit /ppp, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2, është përcaktuar kriteri: “*Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht kualifikimet e mëposhtme: 1. Çertifikatë Akreditimi ISO/IEC 17020:2012 “Kritere të Përgjithshme për Funksionimin e Tipeve të Ndryshme të Organizmave që Kryejnë Inspektime” – në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarësve të karburantit dhe gazit të lëngshëm të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”.*

III.3.2. Gjithashtu në dokumentat e tenderit është publikuar dhe shtojca për termat e referencës ku përcaktohen detaje në lidhje më këtë shërbim.

III.3.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktues mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

III.3.4. Në nenin 30 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktues, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Çertifikata ISO/IEC 17020:2012 (e kërkuar nga autoriteti në DK) është një standard në fushën e vlerësimit të konformitetit - kërkesave për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektimin dhe për paanshmërinë dhe konsistencën e aktiviteteve të tyre inspektuese.

Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar edhe në dokumentacionin e kësaj procedure konkurruese, specifikimeve teknike, termave të referencës të publikuar nga autoriteti kontraktues, gjykon se kërkesa për këtë kriter nuk është e ekzagjeruar dhe është në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, duke vlerësuar se është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e një dokumenti të tillë në fushën e inspektimit për verifikimin e shpërndarëseve të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për lëshimin e çertifikatës ISO/IEC 17020:2012 nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, KPP sqaron se, autoriteti kontraktues argumenton se: *“Duke qenë se shërbimi që do të jepet me koncesion, shtrihet në territorin e RSH-së, është e logjikshme që të ketë njohje ligjore dhe besueshmëri nga një organ vendas në lidhje me të. Për më tepër, DPA ka parashikuar mundësinë e njohjes ose pajisjes me akreditimin përkatës, te organizmave që nuk janë pajisur në vendin tone me certifikimet përkatëse, sipas kërkesave ligjore për standardin ISO/IEC17020:2012 “Kërkesa të përgjithshme për operimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim”, sipas kërkesës se tyre në përputhje me Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.*

Pra sa më sipër, autoriteti kontraktues ka sqaruar se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ka parashikuar mundësinë e njohjes ose pajisjes me akreditimin përkatës, të organizmave që nuk janë pajisur në vendin tonë me certifikimet përkatëse, sipas kërkesave ligjore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Në lidhje me formën e dokumenteve të ofertuesve të huaj, DSK dhe konkretisht Shtojca 8 kanë parashtruar kërkesa kontradiktore përsa i përket gjuhës së dokumentave. Konkretisht, në një paragraf të Shtojcës 8 kërkohet që cdo dokument në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe me vërtetim noterial ndërsa paragrafi i mndit i Shtojcës 8 parashikon dhe pranimin e dokumenteve në gjuhën angleze.*

Kërkojmë që të sqarohet përfundimisht gjuha e dokumenteve të huaj dhe Autoriteti Kontraktues të sqarojë në DSK edhe pranimin e dokumenteve në gjuhën angleze ne mbështetje të Ligjit 125/2013 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, i cili parashikon në nenin 1 të tij se ka për qëllim “...të krijojë një kuader të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet si koncensione partneritete publike private , Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e koncesionit/ppp, Seksioni 4, pika 4.6. është përcaktuar:

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip X Anglisht Tjetër _____”

III.4.2. Në dokumentat e koncesionit, Shtojca 8 është përcaktuar: *“Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendura”.*

Po këtu është përcaktuar: *“Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe ose angleze, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën “Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës”.*

III.4.3. Autoriteti kontraktues në informacionin e depozituar sqaron se:

“Në lidhje me pikën 2 “Forma e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi”, sqarojmë se gjuha e dokumentacionit që do të paraqitet nga ofertuesit është gjuha shqipe. Kjo është në përputhje me rregullat e përgjithshme të vendosura nga Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, si dhe në nenin 29 të Ligjit nr. 9643, datë 20.1 1.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili parashikon se në përmbajtjen e njoftimit të procedurës së hapur, duhet të përcaktohet gjuha e hartimit të ofertave. Për aq kohë sa në njoftimin e kontratës, është përcaktuar gjuha shqipe, nënkupton që dhe ofertat do të dorëzohet në këtë gjuhë.

Gjithashtu, sqarojmë se nga përcaktimi i bërë në Dokumentet e Tenderit, ku thuhet se “Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe ose angleze, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën “Apostille do të kuptohet se noterizimi apo vulosja “Apostille” përbën vlerën juridike që merr dokumenti, e vecanërisht për dokumentet nga vendet e huaja, nënkupton garanci ligjore për Autoritetin Kontraktues. Sa më sipër, nuk rrëzon kërkesën për paraqitjen e ofertave në gjuhën shqipe, por është një kërkesë legjitime për origjinalitetin e dokumentacionit që do të përbëjë ofertën”.

III.4.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 14, përcaktohet se: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktues, në kushtet kur kemi të bëjmë me një procedurë të hapur, ka përcaktuar që gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe, dhe çdo dokument në gjuhë tjetër duhet të noterizohet në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “Në seksionin 5.3 të DSK (Informacione shtesë) parashikohet se dokumentacioni i cili do të ngarkohet në faqen e APP-se si (studimi i fizibilitetit, detyrat e projektimit, etj) i cili do t’i bashkëlidhet dokumentave të tenderit është referues (orientues) për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e koncesionit.

Në rastin konkret, në faqen e APP nuk është ngarkuar studimi i fizibiliteti duke cënuar haptazi parimin bazë të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve pasi na privon nga informacioni bazë në funksion të vlerësimit tonë të plotë për të marrë pjesë ose jo në procedurë si dhe realizimin e një oferte të plotë dhe të kënaqshme sipas pritshmërive të AK dhe kërkesave në DSK. Ky informacion në rastin konkret, duket se është i privilegjuar vetëm për shoqërinë NOA Control e cila e ka hartuar vetë këtë studim. Një mënyrë e tillë operimi favorizon dukshëm ofertuesin e mundshëm të cilit i është akorduar dhe bonusi, NOA Control.

Jo vetëm kaq, por mungesa e studimit të fizibilitetit dhe të dhënat e tij në lidhje me situatën aktuale në treg, numrin e pompave, standanet dhe perceptimin e publikut etj, nuk na japin mundësinë që të kemi bazën e nevojshme (supozimet) mbi të cilat të mundet që të ndërtojmë modelin tonë financiar dhe planin e biznesit sipas kërkesës të parashikuar në pikën 2.2 (e) Shtojca 8 n’e ‘ të cilin kërkohet që ofertumi të hartojë një model financiar i cili duhet të përmbajë ‘ pasqyrat financiare të fluksit të parasë (Cash Floë), të ardhurat, shpenzimet kapitale, shpenzimet operative, burimet e financimit të projektit, riinvestimin si dhe indikatorët financiarë si IRR, NPV etj; per gjithë kohëzgjatjen e kontratës; të përgatishim në kushte të barabarta me ofertuesin të cilit i është dhënë bonusi ofertën teknike dhe financiare per vleresim sipas kriterëve të parashikuara në Shtojcën 10 të DSK, konkretisht KT2, KFl (vlera totale e investimit) dhe KF2 (tarifa e koncesionit). Sa më sipër, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të vendos në dispozicion të procedurës konkurruese studimin e fizibilitetit për këtë koncesion”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e koncesionit/ppp, Seksioni 5, është përcaktuar: “5.3 *Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumenteve të tenderit) Dokumentet do të publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Kujdes: Dokumentacioni i cili do të ngarkohet në faqen e APP-se si (studimi i fizibilitetit, detyrat e projektimit, etj) i cili do të bashkelidhet dokumentave të tenderit është referues(orientues) për operatorët ekonomike pjesëmarrës në procedurën e koncesionit*”.

III.5.2. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë KPP-së sqaron se: “Në lidhje me pikën 3 “*Mungesa e Studimit të Fizibilitetit: Shtojca 10 Kriteret e Vlerësimit*”, sjellim në vëmendje se informacioni teknik i nevojshëm për të gjykuar mbi pjesëmarrjen në procedurën e hapur Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, mund të merret nga Shtojca 12 “*Termet e Referencës/ Specifikimet Teknike*”, e cila është pjesë e Dokumenteve të Tenderit.

Në studimin e fizibilitetit, shoqëria ka parashikuar edhe të dhëna të cilat janë të lidhura ngushtë me teknologjinë e përdorur dhe parashikimet financiare, cka do të konsiderohet çënim i konkurrencës nga propozuesi i pakërkuar. Por pavarësisht sa më sipër, Autoriteti Kontraktues ka publikuar të gjitha të dhënat e nevojshme, sipas Shtojcës 12 të dokumenteve të koncesionit, duke përfshirë detaje edhe më të hollësishme se ato që kërkon ankimuesi. Përsa i përket të dhënave të nevojshme për përgatitjen e kriterëve të vlerësimit, shprehemi se publikimi i studimit të fizibilitetit jo vetëm që nuk i ndihmon operatorët, por i kufizon ata në përgatitjen e një oferte, e cila mund të mos jetë reale dhe ka tendencën të përafrohet me atë cka studiuar propozuesi i pakërkuar. Në rastin e koncesionit, në ndryshim nga prokurimi publik tradicional, vlera më e mirë për para arrihet nëpërmjet përgatitjes së studimit nga operatorët privatë, të cilët do të ofrojnë vlerën me të mirë duke zhvilluar projektin sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktues.

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës konkurruese konstatohet se autoriteti kontraktues ka publikuar edhe Shtojcën 12 “*Termet e Referencës/Specifikimet teknike*”, në të cilën janë të përshkruara detaje të hollësishme në lidhje me këtë procedurë, të dhëna të domosdoshme këto dhe të mjaftueshme për të hartuar ofertën përkatëse.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi. Referuar sa më sipër, ashtu siç edhe autoriteti kontraktues sqaron, informacioni teknik i nevojshëm për hartimin e ofertës për pjesëmarrjen në procedurën e hapur “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, merret nga Shtojca 12 “*Termet e Referencës/ Specifikimet Teknike*”, e cila është pjesë e Dokumenteve të Tenderit”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “*Ky koncesion nuk duhet trajtuar si propozim i pakërkuar VKM nr. 575/2013 “Per miratimin e rregullave për vlerësimin*

dhe dhënien me koncenssion/partneritet publik privat", i ndryshuar, parashikon në nenin 10, pika 1 se cdo operator ekonomik ose grup operatoresh mund të paraqesin një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP, kjo me kusht që propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve të parashikuar në nenin 4 të Ligjit për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat. Shërbimi që do të ofrohet nga koncensionari në këtë rast nuk i përket asnjë prej sektorëve të parashikuar në nenin 4 të ligjit të cituar më sipër, i cili parashikon sektorët e mëposhtëm: [...].

Në gjykimin tonë, kontrolli ligjor i instrumenteve matëse të shpërndarësve të karburantit nuk përfshihet në asnjë prej sektorëve të mesipërm për të cilët lejohet paraqitja dhe për rrjedhojë marrja në konsideratë nga AK i një propozimi të pakërkuar. Në këto kushte, jemi të mendimit se KPP duhet të udhëzojë AK që të trajtojë këtë koncesion me anë të një procedure standarte të hapur pa akorduar bonus për subjektin i cili ka hartuar studimin e fizibilitetit", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e koncesionit/ppp, Seksioni II Udhëzime për ofertuesit, pika 1.1. Informacioni i mëtejshëm, është përcaktuar: "Objekti i Kontratës së Koncesionit do të jetë shërbimi i kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës (GLN).

1.2 (vetëm për propozimet e pakërkua) Projekti koncesionar për kontrollin ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës (GLN) është propozimi i pakërkuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktues. Bazuar në VKM nr. 365, datë 20.6.2018 "Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese", shoqëria "NOA Control" sh.p.k ka përfituar një bonus prej 10% të totalit të pikëve. 1.3 Këto udhëzime ("Udhëzimet për Ofertuesit") si dhe "Ftesa për Ofertë" i adresohet të gjithë subjekteve juridike ose bashkimeve

III.6.2. Autoriteti kontraktues në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: "Ne lidhje me pikën 4 "Ky koncesion nuk duhet trajtuar si propozim i pakërkuar", sqarojmë se Vendimi nr. 365, datë 20.06.2018 i Këshillit të Ministrave, ka përcaktuar përfshirjen e shërbimit objekt propozimi në fushën e sektorëve që mund të jepen me koncesion/PPP, si dhe dhënien e bonusit për shoqërinë që ka paraqitur propozimin e pakërkuar. Nga interpretimi sistematik i legjislacionit që trajton koncesionet dhe partneritetin publik privat, arrijmë në konkluzionin se propozimi i pakërkuar referohet si një mënyrë ofrimi për të gjithë sektorët e mundshëm të koncesioneve e për sa kohë që Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë vendime për dhënien me koncesion në sektorë të tjerë, si dhe përderisa ky përcaktim është vendosur brenda nenit 4 "Fusha e zbatimit të ligjit" të Ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", të ndryshuar, do të thotë që qëllimi i ligjvënësit është trajtimi i përgjithshëm i sektorëve të tjerë të mundshëm, në të njëjtën mënyrë si sektorët e përcaktuar.

Gjithashtu, sipas pretendimit të operatorit ekonomik që Autoriteti Kontraktues të trajtojë koncesionin me anë të një procedure standarte të hapur pa akorduar bonus për subjektin që ka hartuar studimin e fizibilitetit, rikujtojmë se ky nuk është diskrecion i Autoritetit Kontraktues, pasi

dhënia me koncesion e këtij shërbimi, si dhe vlerësimi me bonus për propozuesin, janë përcaktuar në VKM-në e sipërmendur”.

Gjithashtu, autoriteti kontraktues, informon se, procedura konkurruese është përzgjedhur “Procedurë e Hapur”, pas miratimit të dokumentave të tenderit në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

III.6.3. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ka të bëjë me një kundërshtim ligjor të Vendimit të Këshillit të Ministrave, pretendim ky që tejkalon tagrat e Komisionit të Prokurimit Publik, i cili, shqyrton ankesat e paraqitura për prokurimet publike, koncesionet/ppp, ankande, leje minerare, në lidhje me një vendimmarrje të autoritetit kontraktues përsa i përket procesit të prokurimit të një procedure, të tilla si hartimi i dokumentave të tenderit, si edhe procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Paqartësi në lidhje me Shtojcën 12 (Specifikimet Teknike) dhe Shtojcën 16 (Kushtet e Vecanta të Kontratës).*

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, konstatojmë se si Shtojca 12 ashtu edhe Shtojca 16 kanë mangësi të theksuara në lidhje me llojin dhe numrin e shërbimeve që do të mund të ofrohen nga Koncesionari si dhe vlerën/tarifën dysheme apo tavan për këto shërbime gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, element ky i cili përsëri vjen në kundërshtim flagrant me Nenin 9 të Ligjit për Koncesionet që parashikon trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomike në procedurat konkurruese.

Pa patur qartësi në lidhje me pikat e mësipërme, një ofertues e ka të pamundur të ndërtojë supozimet mbi të cilat do të ndërtojë planin e investimit dhe ri-investimit si dhe modelin e biznesit, të vlerësojë risqet ligjore dhe politike në lidhje me koncesionin si edhe përputhshmërinë e ofertës së tij me kuadrin ligjor në fuqi.

Për shembull, në Shtojcën 12, përmendet se operatori mund të vendosë gjoba ndaj subjekteve, të bëjë riparimet e matësve, kontroll vizual të matësve, kontrolle për herë të parë, kontrolle rastësore etj, të gjitha këto të cilat supozojnë shërbime të ndryshme të cilat mund të ofrohen nga koncesionari por pa përcaktuar në mënyrë të saktë dhe të qarte në listën e shërbimeve të cilat do të ofrohen në bazë të këtij koncesionari nga Koncesionari dhe jo nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë apo ndonjë drejtori tjetër shtetërore.

Gjithashtu, në DSK parashikohet se tarifa ekzistuese është 7,200 Leke (përfshirë TVSH) për cdo distributor sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Ekonominë dhe Financat nr.2, datë 08/02/2013 “Për tarifën dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme si edhe se frekuenca e verifikimeve ” dhe se verifikimi periodik (pasardhës) për të ruajtur saktësinë e matjes së distributoreve të karburanteve dhe të gazit të lëngshëm bëhet do 6 muaj, sipas urdhrin të ministrit Nr.195, date 09/03/2009 “Për verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluara”.

Por në DSK, nuk sqarohet nëse pritshmëria e AK është që si tarifa ashtu dhe frekuenca e verifikimeve periodike do të mbeten të njëjta apo do të mund të ndryshohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit, dhe nëse mund të ndryshohet apo negociohen midis palëve, cilat janë

marzhet mbi të cilat mund të kryhet kjo negociatë. Duke qënë se këto janë kushte kryesore komerciale të kontratës së koncesionit (pasi të ardhurat e koncesionit varen pikërisht nga këto dy kushte), gjykojmë se në DSK duhet të ishin përcaktuar qartë dhe në mënyrë të saktë:

- Lista rendore e shërbimeve të ofruara nga Koncesionari
- Cmimet aktuale për çdo shërbim dhe qartësi nëse këto cmime mund të ndryshohen ose jo gjatë kohëzgjatjës së koncesionit;
- Frekuenca e shërbimeve.

Një parashikim i tillë është në interes jo vetëm të ofertuesve potencialë të cilët duhet të konkurromë në procedura mbi premisa të barabarta por edhe, distributorëve dhe konsumatorëve fundorë për të shmangur abuzimet gjatë kohëzgjatjas së koncesionit nga koncesionari.

Sa më sipër, kërkojmë që KPP të udhëzojë Autoritetin Kontraktues të sqarojë në DSK:

- Të gjitha shërbimet që mund të ofrohen nga Koncesionari;
- Marzhet brenda të cilëve mund të negociohen tarifat e shërbimeve;
- Frekuenca e shërbimeve”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.7.1. Në dokumentat e koncesionit të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike, autoriteti kontraktues ka hartuar Shtojcën 12 Termat e Referencës dhe Shtojcën 16 Kushtet e Veçanta të Kontratës, në të cilat janë përcaktuar në detaje të dhënat për shërbimin e kërkuar.

III.7.2. Në nenin 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

Në nenin 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Në çdo rast, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.7.3. Autoriteti kontraktues në lidhje me pyetjet dhe paqartësitë e ngritura nga operatori ekonomik ankimes, sqaron se: “Në lidhje me pikën 5 “Paqartësi në lidhje me Shtojcën 12 (Specifikimet Teknike) dhe Shtojcën 16 (Kushtet e Veçanta të Kontratës)”, theksojmë se objekt koncesioni është shërbimi i kontrollit ligjor i instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpëmdarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, të përcaktuar në pikën 2.2 të “Njoftimit të Kontratës”. Ky shërbim do të shoqërohet nga ndërtimi i një platforme elektronike Online si dhe krijimi i një baze të dhënash mbi kontrollet periodike të bërë dhe rezultatet e tyre për qëllime evidence.

Në Shtojcën 12, përcaktohet tillimisht lista e operacioneve (shih pikën 1.3.3 Kontrollet metrologjike ligjore) ku përfshihen:

- Miratimi i Tipit
- Verifikimi Fillestar
- Verifikimi Periodik/Jashtë Radhe
- Kontrolli vizual-teknik, etj.

Frekucenca e këtij shërbimi është përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 2, datë 08.02.2013 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmanjes dhe Ministrit të Financave. Në lidhje me çmimin e shërbimit, kjo është parashikuar në Shtojcën 12 “Termet e Referencës/ Specifikimet Teknike”, pika 1.1.2 6 cila shprehet se kjo tarife është 7.200 Lekë (përfshirë TVSH). Ndërsa për sa i përket rekomandimit të operatorit ekonomik mbi vendosjen e cmimit të shërbimit për përdoruesit fundor si kriter vlerësimi financiar, sqarojmë se një kërkesë e tillë nuk mundet të jetë objekt vlerësimi apo rishikimi nga ana e Komisionit të Koncesionit, pasi është e mirërregulluar me Udhëzimin e sipërpermendur, ende në fuqi[...].”

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, si edhe përcaktimi i specifikimeve teknike, duhet të jetë i saktë, i qartë, në mënyrë që edhe operatori ekonomik të bazohet në të dhëna të sakta gjatë hartimit të ofertës së tij.

III.7.5. Në lidhje me sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktues ashtu siç ka sqaruar dhe argumentuar në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka sqaruar se në shtojcat përkatëse si shtojca 12 dhe ajo 16, janë përcaktuar të dhënat e duhura dhe për të cilat kanë lindur paqartësi për ankimuesin. Gjithashtu, autoriteti kontraktor sqaron se në Udhëzimin nr. 2, datë 08.02.2013 të Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrit të Financave, janë përcaktuar frekuencat përkatëse.

Pra autoriteti kontraktor ka sqaruar se të gjitha të dhënat për të cilat ngrihen pretendime nga ankimuesi gjejnë pasqyrim në shtojcat 12 dhe 16 dhe në Udhëzimin e sipërpermendur ku janë rregulluar të gjithë elementët e domosdoshëm për hartimin e ofertës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Penzoil Trading SA” për procedurën konkurruese “E hapur”, me objekt: “Për kontrollin ligjor të instrumentave matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës (GLN)”, me nr. REF-85913-09-17-2018, me fond limit 64.890.600 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 18.10.2018, nga autoriteti kontraktues Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
2. Autoriteti kontraktues lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme konkurruese.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1539 Protokoli,
Datë 28.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Nënkryetar
Enkeleda Bega